



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes 31.03. 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes së datës 31.03. 2022.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **date 31.03. 2022** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet në ambientet e hotel “Çajupit”.

Marrin pjesë në mbledhje 20 anëtarë. Mungojnë në mbledhje; Rova, Kallajnxhi, Isaraj, Hilaj, Feruni, Arapi, Xheko, Çamani, Rami, Kore, Nebiaj.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani. Është korumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Lavdi Hasani Lexohen kërkesat nga grupet e interesit.

Z. Hasani: Këshilli Bashkiak ka qenë dhe është i ndjeshëm ndaj kërkesave të qytetarëve.

2 nga ankesat janë paraqitur konform Rregullores së K. B, neni.73 brenda afatit. Kemi dhe dy kërkesa të tjera të cilat janë paraqitur pas afatit po I pranojmë për t’i dhënë prioritet kërkesës së bizneseve të Pazarit dhe një kërkesë nga banorët e fshatit Kardhiq për varrezat e fshatit.

Sygjerohet që kërkesat të trajtohen në fillim të mbledhjes për të mos penguar bizneset në punën e tyre.

Z.Llogo: Duke parë me përparësi bizneset e pazarit të cilët kanë lënë punën, mendoj që të trajtojmë të parën kërkesën e tyre pas miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve.

Z.Rexhaj: Fillojmë me pazarin më tej me Shoqatën “Çerçiz Topulli”.

Z. Lavdi Hasani lexon rendin e ditës

1. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.03. 2022**”.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.03. 2022**”.
3. P/Vendim “Për miratimin e tavaneve përgatitore buxhetore për PBA 2023-2025 në Bashkinë Gjirokastrë”.
4. P/Vendim “Për një saktësim të emërimit të zërave të projektit “Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull”, të miratuar në VKB nr 6, datë 18.02.2022”.
5. P/Vendim “Për miratimin e sipërfaqeve të tokave për t’u dhënë me qira”.

6. P/Vendim "Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2022 dhe sezonin dimëror 2023".
7. P/ Vendim "Për miratimin e rezolutës".
8. P/Vendim "Për mbështetje në vlerën 100.000 lekë për rastin Gëzim Muxhaj".
9. Trajtim i kërkesës së Shoqërisë së Transportit "Çerçiz Topulli".
10. Trajtim i kërkesës së Dhomës së Avokatisë Gjirokastër.
11. Të ndryshme.

Miratohet rendi i ditës me 20 vota pro.

Z.Hasani: Kush është dakord për dy çështjet e para ? Miratohet me 20 vota pro:

Miratohet dhënia e fjalës për :

1. Kërkesa e bizneseve të Pazarit
2. Trajtim i kërkesës së Shoqërisë së Transportit "Çerçiz Topulli"
3. Kërkesa e Dhomës e Avokatisë.

Kërkohet fjala nga z. Ibrahim Kuka si përfaqësues i bizneseve të Pazarit. Paketa fiskale 2022 Në këtë paketë fiskale të tarifohet hapësira publike në Zonën e Pazarit 20 lekë/ m<sup>2</sup> për një orë . Kjo është shpikje.

Z.Hasani: Të paraqesin argument sipas vendimit, nuk lejohet të kalojnë në komente e fyerje.

Z:Ibrahim Kuka : 20lekë m<sup>2</sup> për orë 16orë/ 96 mijë lekë në muajë kjo tarifë është e papërbalueshme. 100m<sup>2</sup>/86mijë lekë në sezon.

I jepet fjala Z.Golemi: Marr shkas nga spekulimet në lidhje me taksat në Zonën e Pazarit, e cila është zemra e zhvillimit ekonomik të Bashkisë Gjirokastër me shërbime dhe aktivitete në kurriz të taksapaguesve gjirokastrit.

Kemi bërë mbledhje për tarifatat dhe taksat dhe duhet të jemi të barabartë. Ne parashikojmë të mbledhim nga tarifatat e shërbimeve në Pazar 10 milion lekë të vjetra, të cilat ia delegojmë TID për shërbimet që ofron, por nga të ardhurat e pazarit 65 subjekte pa tarifa vendore të paguara për vitin që kaloi.

Ka biznese që në 19/20/21 nuk kanë paguar. Vitin e kaluar kishte anarshi totale në Pazar , kam patur ankesa të shumta nga qytetarët, dhe për të lejuar të shikohet zhvillimi i zonës dhe frymëmarrje për biznesin pas pandemisë kemi patur shumë kosto.

Jemi mbledhur dhe për konsultim publik. Rruga nuk jepet. Është vendosur me orë dhe koeficient 30%,50%,70% e 20 lekshit. Ka dyqan me 1m<sup>2</sup>,10m<sup>2</sup> e më tepër, sa është gjatësia e fasadës.

Para se të bëjmë publike Rregulloren në Pazar dhe para se ta sjell në Këshill do të doja konsultim me bizneset e pazarit, kështu që shikojeni dhe jemi të hapur për sygjerimet dhe propozimet tuaja.

Çfarë jepet hapësirë publike me sheshet patjetër që kanë tarifa të ndryshme.

Për pjesën e tarifave bëni pagesat e tarifave. 65% kanë problem me pagesat.Propozoj që tarifa 20lekë/ m<sup>2</sup>/orë mund ta zbresim në 10lekë për m<sup>2</sup>për orë.

Koeficienti i shfrytëzimit do të bëhet publik.Kjo rregullore do të jetë ligj për funksionimin e pazarit.

Z. Brahimi : Jemi të detyruar të marrim në konsideratë. Unë sygjeroj që ndarja e rrugës të jetë e qartë, ku lejohet dhe ku nuk lejohet.

Orari të jetë i afishuar dhe të drejtën për të lidhur kontratën ta kenë ata që paguajnë taksat. Të mos lidhin kontratën pa shlyer detyrimet .

Tarifa të rregullta me grupet e interesit te presim deri ne mbledhjen tjetër.

Z.Golemi:Nuk është vepruar sepse do kalojë edhe rregullorja. Ju lutem përgjegjshmëri për pazarin, paguani detyrimet që keni.

Z.Qeli: Dakort me propozimin kryetarit. Nuk duam të mbytet biznesi, të njihen me rregulloren dhe të jenë të ndërgjegjshëm për pagesën e detyrimeve.

Z.Naçi: Ne e shohim me sytë tanë ndryshimin dhe investimet që janë bërë nga qeveria në vitet e fundit në Pazar. Pazarin e shohim të gjallëruar. Të rishikohet dhe rregullorja.

A.Karagjozi: Dakord me propozimin e kryetarit për uljen e tarifës për hapësirat publike, por duhet të jenë të rregullt dhe të drejtë për taksat e pazarit dhe për pjesën tjetër të taksapaguesve të tjerë të qytetit . Ky është një vit special në koherencë edhe me situatën e luftës.Të mos heqim taksat, të shohim dhe në varësi të situatës

A.Rexhaj: Bizneset nese nuk e përballojnë nuk i dertyron njeri të marrin hapësirat publike. Pazari u ndryshua dhe ndryshimet i shohim. Në qytetet e tjera janë 40lekë /m<sup>2</sup>

Z.Hasani: Nuk lejohet të zihet rruga, kalojnë pleq, çifte të reja në mes të tavolinave të vendosura pa kriter ku njerëzit hanë e pinë. Në Pazar edhe çmimet janë të ndryshme dhe krahasimisht shumë më të larta se në “18 Shtatori”.

Z.Kuka :Qëllimi është mos të bllokohet rruga, të paguhen taksat

Z.Hasani: Në Pazar bëhen aktivitete nga Bashkia me qëllim shtimin e frekuentimit, por të bëhet kujdes edhe me çmimet.

Z.Golemi: 180mil lekë janë parashikuar për ndërhyrje në Zonen Muzeale.

Sheshet janë me tarifa të tjera nga hapësirat publike.

Kërkesa 2:Trajtim i kërkesës së Shoqërisë së Transportit “Çerçiz Topulli”.Përfaqësues Z. Zenel Peçi.

Trasporti ka problem të mëdha. Rritja e cmimit te naftës, gjykoni si do zgjidhet të çohet bileta 10lekë të shtohet ose të subvencionohet nga bashkia , kërkoj të ndryshohet gjykoni me llogjikë sepse ne dalim çdo ditë me humbje.

Z.Hasani: Ne nuk kemi një flotë siç i kërkojnë kërkesat e kohës, edhe unë jam dakord të ngrihet, por të dëgjojmë edhe mendimin e ekzekutivit

Z.Golemi: Faleminderit për fjalën. Kjo Shoqëri ka probleme të shumta. Kontrata është lidhur në 2019, por nuk i ndan linjat me operatorë, janë 10 operatorë që kanë ardhur .Është rritur çmimi dhe e rritën cmimin vetë. Kjo shoqëri nuk funksionon. Nuk është paraqitur në Këshill miratimi i kontratës. Propozimi nga ne është zerimi i tarifave vendore për shoqërinë. Do vazhdojë me 300 lekë sa të rishihet kjo kontratë. Unë propozoj zerim të tarifës vendore të bashkisë.Miratimi varet nga ju.

Të zerohet tarifa vendore varet nga ju jo unë.

Z.Golemi: Unë mbroj interes e qytetarëve.Nuk mund të lejojmë ngritjen e çmimit të biletës.

Z.Hasko. I dimë të gjithë kushtet. Secili kërkon zgjidhje. Ta provojmë një muaj me 40 lekë .

Z.Qeli: Kryetari bëri zgjidhje të drejtë, rëndoi bashkinë. Hoqi taksën për këtë muaj.

Z.Rexhaj; Janë në vështirësi dhe ne e kuptojmë, sesi do zgjidhet, janë ngritur çmimet.

Përfaqësues I Bebej Jam: Çmimi është rritur dhe sot jemi me humbje. Nuk e çova çmimin sepse respektoj kontratën. Të rishikohet çmimi për 3 muaj.

E.Guga:Duke bërë një llogari të thjeshtë një person 600 l të reja për një muaj, për 4 persona 2400 lekë. Çdo rritje e koston dëmton qytetarët, por nuk mendoj se kostot e rritjes së çmimit duhet t'i ketë bashkia.

Z. Brahimi.: Çmimet janë rritur dhe është paralizë që nga pandemia. Duhet rishikuar njësitë administrative. I kanë rritur biletat, pse nuk merni masa për shoqëri të tjera?

Z.Golemi: I marr parasysh shqetësimet tuaja, kaq me lejon ligji, nuk mund të shkel ligjin.

Nuk ka dalë paketa e qeverisë, jemi në pritje.Kur të kemi amendim kontrate të rishikohet çmimi i biletës. Ne do të rishikojmë kontratat dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e palëve.

Znj. Qafzezi: Shoqëria del me bilanc negative. Por edhe rritja e çmimit është kosto për njerëzit në nevojë.

Z.Hasani: Të ulet ekzekutivi me shoqërinë e transportit dhe të na e sjellë ekzekutivi me propozim në mbledhjen e radhës.

Z.Golemi: Deri në një mbledhje të dytë zerojme tarifën vendore për Shoqërinë e transportit. Kaq mund të bëjmë.

Miratohet me 19 vota pro dhe 1 kundër propozimi për zerim të tarifave që paguhen në bashki dhe çdo ndryshim për tarifën e transportit do të kryhet vetëm me ndryshimin e ligjit sipas përcaktimeve të bëra në kontratë dhe në pritje të paketës së ndihmës nga pushteti qendror për situatën në të cilën jemi.

Z. Hasani: Kërkesa e Dhomës së Avokatisë nëse biem dakord të hartojmë një rezolutë drejtuar qeverisë për transferimin e Gjykatës së Apelit.

Z.Brahimi: Qyteti ynë ka dy deputetë dhe ministra dhe u hoqën me radhë drejtoritë rajonale dhe shërbimet kanë shtuar dhe do vazhdojnë të shtojnë kostot e tyre . Ne duhet të ngremë zërin për këto drejtori dhe për projektin e Gjykatës së Apelit.

Z. Rexhaj nuk është marë vendimi është projekt.

Z. Zhapa .Nuk mund të heshtim Por duhet të ngremë zërin

Z.Qeli: Ishim kundër, nuk na pyeti njeri, ta bëjme një rezolute, takim me deputetet dhe hartimi i një rezolute.

Z.Hasani :Nga pleqësia e fshatit Kardhiq na ka ardhur një kërkesë në lidhje me varrezat e fshatit. Mendoj t'i hapet rruga ekzekutivit për të vazhduar më tej me procedurat.

Miratohet me 19 vota pro hapja e rrugës ekzekutivit për të vazhduar me procedurat e mëtejshme sipas përcaktimeve ligjore.

Miratohen me 19 vota pro procesverbalet e mbledhjes së datës 28.02 dhe 10.03.2022.

Miratohen me 19 vota 2 p/ vendimet e ndihmës ekonomike.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.03. 2022**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.03. 2022**”.

Sqarime nga znj. Artiste Koko në lidhje me Miratimin e tavaneve përgatitore.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2022, 3 bashki nga 61 nuk do të aplikojnë 20 programe por 10 programe. Do të zbatohet planifikimi me 10 programe te zbatimit të buxhetit për tavanet nga 20/10

Z.Rexhaj :Kancelari per shkollat. Mungojnë shumë mjete kancelarie në shkolla. Nga kush duhet t’i marrim?

Znj.Koko. Është fond i deleguar. Bashkia Gjirokastër zbaton grantin e kushtëzuar.Fond i deleguar nuk mjafton.

Z.Golemi: Janë zëra të veçantë, por duhet edhe mire administrim dhe menaxhim nga shkollat.Kemi dyfishuar naftën në shkolla.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për miratimin e tavaneve përgatitore buxhetore në bashkinë Gjirokastër për 2023-2025”.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për një saktësim të emërimit të zërave të projektit “Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastër dhe Dropull”, të miratuar në VKB nr 6, datë 18.02.2022”.

Z. Bexhet Baxhella; Pas miratimit nga ana juaj vazhdon procedura me shpalljen në faqen e bashkisë dhe më tej vazhdon me paraqitjen e projekteve nga personat e interesuar.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për dhënien e tokave bujqësore me qira”.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim“Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2022 dhe sezonin dimëror 2023”.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për miratimin e rezolutës”.

Z. Zhapa: Të mbahet parasysh plotësimi I dosjes mjekësore në raste të tilla se dosja është e mangët.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për mbështetje në vlerën 100.000 lekë për rastin Gëzim Muxhaj.

Në pikën të ndryshme u diskutuan nga këshilltarët probleme që shqetësojnë banorët dhe që kanë të bëjnë me punimet në rrugë, rrëzimin e mureve në lagje të ndryshme, ndërhyrjet në qendrat e NJ. Administrative etj.

**Mbyllet mbledhja në orën 16.45**

**Sekretar i Këshillit**

**Etleva Yzo**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Lavdi HASANI**

